



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2340/2 prot

Pukë, më 28.02.2025

VENDIM

Nr. 04, datë 25.02.2025

**“PËR MIRATIMIN E KALENDARIT TË PËRGATITJES SE PROGRAMIT
BUXHETOR AFATMESËM 2026 – 2028 DHE BUXHETIN VJETOR 2026”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 të miratuar më datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar nenit 33 të ligjit nr. 68/2017 date “Per financat e veteqeverisjes vendore” i ndryshuar ligjit nr. 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar ,ligjit nr, 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar , udhezimit nr. 23 date 30.07.2018 “Per procedurat standarte te pergatitjes se Programit Buxhetor Afatmesem të njesive të qeverisjes vendore” të ndryshuar, udhëzimi nr. 9 datë 20.03.2018 “Mbi procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, të ndryshuar, sipas materialit të përgatitur nga administrata e bashkisë dhe me propozim të kryetarit të Bashkisë, Keshilli Bashkiak në mledhjen e tij të datës 25.02.2025, pas shqyrtimit:

VENDOSI:

1. Miratimin e Kalendarit të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe buxhetit vjetor 2026 sipas tabelës 1 bashkelidhur këtij vendimi
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”
4. Vendimi u shpall me date 26 .02.2025.

Vota te vlefshme gjithsej : 9

Vota pro 9 , vota kunder 0, vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni

KRYETARI

Gjon GJOKA



Tabela nr 1

KALENDARI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM DHE BUXHETIT VJETOR 2026-2028		
Pershkrimi I fazave	Afatet	Procedurat perkatese
Kalendari I PBA dhe buxhetit vjetor	Brenda muajit Dhjetor	Përgatit dhe paraqet në Këshillin bashkiak kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
	Deri - 31 Dhjetor	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm
Vlersimi dhe parashikimi I te ardhurave dhe shpenzimeve	31 Janar	Kryetari i njësisë paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin e vlerësimit të të ardhurave për PBA 2026-2028
	1 Mars	Paraqet në këshill e Miraton raportin e vlerësimit të të ardhurave për PBA-në 2026- 2028
Miratimi I tavanave,shperndarjen te njesite shpenzuese,shqyrtim kerkesave dhe Miratim I PBA faza e pare	Brenda dates 15	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-se tavanet përgatitore të shpenzimeve te PE
	15 Mars	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028
	21 Mars-25 Prill	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore
	26 Prill -27 Prill	Zhvillojnë takime konsultative me shoqerine civile dhe grupet e interesit per PBA 2026-2028
	28 Prill -30 Prill	Njësitë shpenzuese, sektoret paraqesin kërkesat e përgatitura
	1 Maj- 15 Maj	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
	16 Maj - 26 Maj	Organizon takime dëgjimore me banorët
	27 Maj - 29 maj	Prezanton dokumentacionin e PBA 2026-2028 në komunitete
Dërgon ne MFE dhe reflekton ndryshimet nëse ka	30 Maj - 31 Maj	Perpilon draftin e fazës së parë të PBA -se 2026-2028
	1 Qershore	Dërgon pranë Ministrisë së Financave projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm
	Deri -20 Qershore	Dërgon komente dhe raport me mendime mbi projekt dokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Miratimi I tavanave,shperndarjen te njesite shpenzuese,shqyrtim kerkesave dhe Miratim I PBA faza e dyte	Deri - 25 Qershore	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave nëse ka
	Deri - 30 Qershore	Shqyrton dhe miraton projektin e pare te programit buxhetor afatmesem
	Deri - 5 Korrik	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 te miratuar.
	Deri - 20 Korrik	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm
	25 Korrik	Miraton udhëzimin plotësues të pengatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe e shpërndan tek njësit shpenzuese
	26 Korrik - 31 Gusht	Përgatisin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare
	1 Shtator	Njësite shpenzuese paraqesin kërkesat buxhetore te rishikuara
Dërgon ne MFE projektin e rishikuar	2 Shtator - 14 Shtator	Kryejnë analizat e kërkesave te rishikuara buxhetore
	Deri - 15 Shtator	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar & rekomandimet MFE
Konsultime kalendarin	Deri 5 Tetor (Shtator - Tetor)	Organizohen seanca konsultimi me njësite e veteqeverisjes vendore
PBA faze III përfundimtare dhe miratim buxheti viti 2026	Deri - 20 Tetor	Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t'u reflektuar në dokumentin final te PBA
	6 Tetor - 30 Nëntor	Përgatit projekt buxhetin e vitit 2026 si dhe dokumentin e rishikuar te PBA 2026-2028 dhe paraqet për shqyrtim
	25 Dhjetor	Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtare dhe buxhetin vjetor
	31 Dhjetor	Merr masat per publikimin e dokumentit te plote te programit buxhetor afatmesem

Drejtores e Finances

Fiqirete Latifi

17.03.21

H. Ter Ghujo
F. Idrizi
Për udhëzime
Ezhermet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Shkodër, më 13.03.2025



Nr. 183/1 prot.

Lënda: Mbi Vendimin nr. 4, datë 25.02.2025 të Këshillit Bashkiak Pukë

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave funksionale të ligjit nr. 107/2016 "Për Prefektin", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 41, neni 54, shkronja "k", neni 55 pika 2, neni 64, shkronja "c" të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 33, të ligjit nr. 9963, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 23, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të NJQV", të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", shqyrtoi VKB Pukë nr. 4, datë 25.02.2025 "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2026-2028".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI

